

VENDIM
Nr.46, datë 26.7.2006

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR KRITERET E
DHËNIES DHE HEQJES SË STATUSIT TË KLIENTIT TË KUALIFIKUAR**

Në mbështetje të nenit 9, pika 3 të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, nenit 7 të ligjit nr.9512, datë 10.4.2006 “ Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike””, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.7.2006, pasi shqyrtoi propozimin e paraqitur nga anëtari i Bordit të Komisionerëve z.Adriatik Bego, për miratimin e rregullores për kriteret e dhënies dhe heqjes së statusit të klientit të kualifikuar,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për miratimin e rregullores për kriteret e dhënies dhe heqjes së statusit të Klientit të Kualifikuar.

Ngarkohet Departamenti i Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun, Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit, Departamenti i Tarifave dhe Çmimeve, si dhe këshilltari i Bordit të Komisionerëve, ta përpunojnë këtë rregullore në përputhje me projektdraftin e paraqitur (bashkëngjitur).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta